

# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

**PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM**

# *Shqipëria dhe shqiptarët përballen me një qeverisje që ka dëmtuar rëndë shtetin e së drejtës, ka rrënuar ekonominë, ka varfëruar shqiptarët dhe ka thyer besimin e tyre tek një e ardhme më e mirë.*

Pas vjedhjes masive të zgjedhjeve të 2017, në aleancë me krimin dhe si peng i tij, mazhoranca e sotme nuk ka reshtur së vepruari me arrogancë e paligjshmëri, duke dëmtuar rëndë institucionin e Parlamentit, duke usurpuar institucionet e pavarura, duke mos respektuar Kushtetutën dhe dëmtuar ligjshmërinë, si themel i sistemit demokratik.

Mungesa e legjimitetit në qeverisje dhe paaftësia flagrante e saj kanë sjellë pasoja të rënda për individin, shoqërinë dhe vendin në tërësi.

Si peng i krimit dhe shërbëtore e oligarkëve, qeverisja ka hequr dorë nga përgjegjësitë për t'u mundësuar qytetarëve shërbime publike (veçanërisht shërbime shëndetësore, arsim e infrastrukturë), duke ua dhënë ato me një kosto tepër të lartë prej miliarda eurosh e në mënyra jo transparente klientëve të saj, duke rritur borxhin publik si asnjëherë më parë.

Paaftësia dhe makutëria e qeverisjes po shpaloset veçanërisht që nga ngjarjet e vështira të tërmetit të vitit 2019 dhe tani gjatë pandemisë së Covid-19, ku ende janë të qarta pasojat e rënda të fatkeqësisë natyrore dhe keqmenaxhimit të saj. Pasojat e kësaj keqqeverisje po prekin në kockë shqiptarët. Shoqëria shqiptare, kryesisht rinia, gjendet sot përpara një krize të thellë të besimit dhe po përjeton një emigrim masiv. Si rezultat i keqqeverisjes, vendi ka performancën më të dobët në rajon për treguesit e integrimit në BE. Bashkimi Evropian ka vendosur përpara Shqipërisë një sërë kushtesh që konfirmojnë kritikën që LSI dhe opozita kanë bërë në vazhdimësi për keqqeverisjen.



# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

**PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM**

*Qeverisja ka thelluar polarizimin ekonomik e social të vendit dhe ka dështuar në mbajtjen e premtimeve me të cilat erdhi në pushtet: Përmirësimi i jetës së qytetarëve, hapja e vendeve të reja të punës, shëndetësia falas, arsimimi cilësor, punësimi, taksa dhe kosto jetese më të ulëta.*

Lëvizja Socialiste për Integrim vlerëson se kthimi i shpresës tek qytetarët dhe veçanërisht te rinia për një të ardhme më të mirë është detyrë kombëtare. Kjo fillon me largimin e kësaj qeverie. Shqipëria është e pasur me resurse natyrore dhe potenciale njerëzore për të krijuar mirëqenje dhe shanse për të gjithë qytetarët e saj, sidomos për rininë. Misioni madhor i LSI është ta bëjmë Shqipërinë Shtëpinë Tonë të Përbashkët, të kthejmë besimin se Shqipëria bëhet.

Sfida zgjedhore e 2021-shit, qëndron para së gjithash në largimin nga pushteti dhe ndëshkimin me votë popullore dhe me ligj të atyre që vjedhin vullnetin e sovranit, që premtojnë dhe nuk mbajnë premtimet, që nuk mbajnë përgjegjësi për atë që premtojnë dhe për detyrimet ndaj qytetarëve, që shkelin me bindje ligjet dhe Kushtetutën, që nuk preken dhe nuk veprojnë ndaj shpopullimit të vendit.

Sfida e 2021-shit është gjithashtu ndalja e rënies ekonomike dhe dalja prej krizës së thellë ekonomike e sociale, rikthimi i ekonomisë në kushtet e tregut dhe konkurencës së lirë, çlirimi i ekonomisë nga oligarkët, krijimi i mundësive për punësim dhe për biznes për të gjithë qytetarët, tërheqja e investimeve, transparenca dhe përfundimi i koncesioneve korruptive që kanë boshatisur xhepat e qytetarëve.



**SHQIPËRIA  
SHTËPIA JUAJ**

PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

# *Për këtë, LSI ka planin e saj qeverisës, i cili konsiston në:*

- 1.** Kthimin e vendit në normalitet demokratik, bazuar te zgjedhjet e lira dhe të ndershme, te zbatimi i Kushtetutës dhe pavarësia e institucioneve, te funksionimi normal i sistemit gjyqësor dhe plotësimi i detyrimeve dhe kushteve për integrimin e vendit në Evropë
- 2.** Kthimin e ekonomisë në kushtet e tregut të lirë, çlirimin e ekonomisë nga monopolet, për daljen nga recessioni ekonomik, si kusht dhe premisë për PUNËSIMIN, si përparësi e të gjitha politikave ekonomike. Garantimin e ritmeve më të larta të rritjes ekonomike dhe punësimit në mënyrë të veçantë për rininë dhe gruan.  
Uljen e barrës fiskale.  
Uljen e kostos së jetesës.
- 3.** Investim real tek arsimi dhe rritje e cilësisë së tij. Lidhjen e drejtpërdrejtë të arsimit me tregun e punës
- 4.** Shëndeti Publik, detyrë parësore e qeverisë
  - (i) Financim prioritar dhe i plotë i shëndetit publik për forcimin e kapaciteteve të tij dhe kontrollin efikas të territorit, lidhur me të gjitha sëmundjet ngjitime të përgjithësi dhe pandemisë nga COVID-19 në veçanti.
  - (ii) Moratorium i menjëhershëm për koncesionet në shëndetësi që nga viti 2013 dhe alokim i fondevë për trajtimin e pandemisë dhe pasojave të saj.
  - (iii) Realizimi i autonomisë së shërbimit spitalor.
  - (iv) Ringritje e shërbimit cilësor të Mjekut të Familjes dhe shërbimit parësor në tërsi.
- 5.** Administrata Publike dhe shërbimi civil
  - (i) Reformë të thellë të administratës publike drejt rritjes së profesionalizmit.
  - (ii) Përgatitje e shërbimit civil me kualifikime cilësore për procesin e negociatave dhe integrimit evropian, dhe për tërheqjen e investimeve në ekonomi.
- 6.** Mbështetje për familjen dhe gruan, si mbështetje për themelit e shoqërisë
  - (i) Fuqizim ekonomik i gruas.
  - (ii) Programi 'nga bebjë në bebe'.
  - (iii) Ndalje e shpopullimit.

## **7. Mjedis**

Cilësia e mjedisit është element themelor i shëndetit publik, i zhvillimit të qëndrueshëm, i ekonomisë së gjelbër të së ardhmes si dhe domosdoshmëri për përballimin e pasojave shkatërruese të ngrohjes globale. Do të mbështeten në mënyrë parësore:

- (i) Energjia e gjelbërt, veçanërisht e diellit dhe erës. Do të nxitet dhe mbështetet vendosja paneleve diellore për përdorim shtëpiak.
- (ii) Rikuperimi i ndotjes nga mbetjet urbane dhe aktiviteti ekonomik i tokës, ajrit dhe ujit.
- (iii) Reforma e standardeve të ruajtjes së energjisë në ndërtim dhe e standardeve antisizmike.
- (iv) Kontrolli rigoroz i cilësisë së karburanteve dhe ulja e ndjeshme e kostos së tyre në rreth 20% duke ndryshuar strukturën e kostos (heqje e taksës së qarkullimit nga karburanti).

## **8. Integrimi Evropian**

Synojmë të realizojmë një PAKT KOMBËTAR për Integrin Evropian, ku përfshihet edhe miratimi konsensual i të gjitha ligjeve që bëjnë përafrimin e legjisacionit. Do të fokusojmë resurset dhe energjitet qeverisëse, intelektuale e shoqërore drejt plotësimit të detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkin Evropian, përfshirë edhe përgatitjen e një ekipi profesionist negociator.

## **9. Në Politikën e jashtme synojmë:**

- (i) Rikthimin e Shqipërisë si një faktor aktiv i bashkëpunimit dhe integrimit të rajonit mes vetes dhe Bashkimit Evropian.
- (ii) Mbështetje për shqiptarët në të gjitha trojet e tyre në rajon, si faktor paqeje, zhvillimi dhe integrimi.
- (iii) Bashkëpunim real dhe integrim në të gjitha planet me Kosovën.
- (iv) Përkujdesje reale për diasporën shqiptare, kudo ndodhet dhe angazhim i saj për zhvillimin e vendit.
- (v) Forcim i rolit të Shqipërisë në organizatat rajonale e ndërkombëtare.

*Në rend të parë për realizimin e programit të saj, LSI propozon masat dhe politikat për të sigruuar një ekonomi të hapur dhe të tregut të lirë, rritjen e saj dhe të PUNËSIMIT me pagadijitoze. Për këtë qëllim, investimi kryesor i LSI do të jetë tek ARSIMI.*

## ***I.Mbështetje parësore për arsimin. Lëvizja Socialiste për Integrin angazhohet:***

- (i) Të rrisë buxhetin për arsimin në 5% të PBB nga të cilat 3% t'i jepen arsimit parauniversitar, 1.5% arsimit të lartë dhe 0.5% kërkimit shkencor.
- (ii) Të vendosë "taksën e të ardhmes" për arsimin në masën 1% të fitimit të 200 kompanive më të mëdha.
- (iii) Të rrisë pagat për mësuesit deri në dyfishim brenda mandatit të parë qeverisës dhe të rregullojë profesionin e mësuesit me një status të veçantë që i siguron ata profesionalisht dhe ndihmon në rritjen e cilësisë dhe perfomancën në mësimdhënie.
- (iv) Të frenojë hemoragjinë e braktisjes së shkollës prej mësuesve në zonat periferike nëpërmjet masave nxitëse
- (v) Të standartizojë kurrikulën parauniversitare për nxitjen e mendimit kritik, sipërmarrjen dhe edukimin qytetar të fëmijëve si edhe të përmirësojë afësitë dhe shprehitë digitale të të rinjve nëpërmjet përdorimit me të avancuar të TIK.
- (vi) Të sigurojë tekstet shkollore falas për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.



# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

**PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM**

# *... investimi kryesor i LSI do të jetë tek ARSIMI.*

- (vii) Ligji për Arsimin e Lartë të shqyrtohet në bashkëpunim të ngushtë me trupën akademike të universiteteve shqiptare me qëllim rritjen e cilësisë dhe sigurimin e autonomisë.
- (viii) Të rrisë përfaqësimin e studentëve në të gjithë organet drejtuese të universiteteve deri në nivelin 20%.
- (ix) Të përgjysmojë shpenzimet e studentëve duke ulur tarifat e studimit e njëkohësisht të mundesojë një paketë që siguron uljen e kostos së jetesës së studentëve ku përfshihen banimi, ushqimi, transporti e mjetet mësimore.
- (x) Të orientojë temat studimore në Programet Master dhe Doktoraturë (PhD) në çështje konkrete të zhvillimit të ekonomisë si edhe të forcojë sistemin e bursave shtetërore sipas sektorëve prioritarë me qëllim afrimin e studentëve me kërkesat e tregut të punës.
- (xi) Të përfshijë praktikat e detyruara të punës (internship) në Bachelor dhe Master. Të përshtasë kurikulat e një ose dy viteve të fundit për studentë të veçantë për t'iu përgjigjur nevojave të kompanive (mbi bazë marrëveshjesh qeveri-biznes-shkollë).
- (xii) Të masivizojë programin "Mëso dhe Fito", duke rritur numrin e shkollave profesionale dhe gjithashtu duke përmirësuar kurrikulen profesionale të tyre, me parimin e gërshtetimit të arsimit profesional me marrjen e dijeve teorike duke mundësuar që gjatë vitit shkollor nxënësit edhe të mësojnë, por edhe të zhvillojnë praktika pune të paguara në të njejtën kohë.
- (xiii) Të realizojë prokurim të laboratorëve të biznesit privat dhe infrastrukturën shtetërore për trajnimin praktik të shkollave dhe universiteteve.
- (xiv) Të forcojë kërkimin shkencor dhe inovacionin nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, vendosjes së Statusit të Kërkuesit Shkencor, rinovimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të Legjislacionit.



# **SHQIPËRIA** **SHTËPIA JUAJ**

**PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021**  
**LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM**

## *II. Ekonomia, politikat fiskale dhe ulja e kostos së jetesës.*

- (i) Ulja e barrës fiskale mbi biznesin dhe individin. Vendosja e taksës së sheshtë. Përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat e pagës deri në 35 mijë lekë.
- (ii) Bizneset me xhiro vjetore nga 0-14 milionë lekë, do të trajtohen si biznese të vogla, me TVSH 0% dhe tatim mbi Fitimin 0%.
- (iii) Programi i reimbursimit 5% të vlerës së faturës së çdo blerjeje, me përjashtim të shpenzimeve që kryhen në entet publike.
- (iv) Krijimi i zonave të lira ekonomike me ngarkesë fiskale dhe taksa 0, duke filluar me Zonat e Lira Ekonomike Durrësi 1 dhe 2. Tërheqje e investimeve në IT, industrinë automobilave, etj.
- (v) Mbështetje për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit, si motor i jashtëzakonshëm i zhvillimit ekonomik e social.
- (vi) Rritje e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe eksporteve.
- (vii) PROGRAMI "SHQIPËRIA, SHTËPIA E INVESTIMEVE", transformim rrënjosor i klimës së biznesit, për ta bërë vendin më të favorshëm në rajon për investime të brendshme dhe të huaja.
- (viii) Programe intensive për hyrjen e të rinjve në tregun e punës, programi: "Garancia për të rinjtë".

\* Mbështetje direkte për kompanitë deri në masën 2000 € në vit (ku përfshihen sigurimet shoqërore/shëndetësore dhe pagesa për trajnimin për punonjës) për çdo të punësuar deri në moshën 29-vjeçare që është i regjistruar në zyrat e punës dhe që nuk ka qenë asnjëherë më parë i punësuar ose që ka së paku 6 muaj që është regjistruar si i papunë. Mbështetje direkte nga kompanitë përfitohet në përfundim të 12 muajve të parë të punës (pra kontrata e punës është jo më pak se 1 vjeçare).

\* Kredi të buta me garanci shtetërore me vlerë deri në 25.000€ për SME-të, të cilat drejtohen nga të rinjtë dhe punësojnë të rinj që kanë së paku një vit që operojnë në treg. Ngritje e qëndrave të asistimit të sipërmarrësve të rinj me trajnime dhe këshillim për menaxhim, hartim plane biznesi dhe aplikim kredie.

\* Ngritje e inkubatorëve të biznesit me qëllim nxitjen e start up-eve për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit që do të përftojnë hapësirat e zyrave, pajisjet e punës dhe trajnime e monitorime për bizneset inovatore deri në maturimin e tyre për të dalë në treg.



# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

*PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM*

### *III. Bujqësia/Blegtoria/Agropërpunimi sektorë kryesorë ekonomik.*

- (i) Mbështetje reale për bujqësinë, sektor kryesor ekonomik. Rritje e prodhimit cilësor vendas duke plotësuar nevojat e konsumatorit në tregun e brendshëm. LSI do të mbështesë bujqësinë në një vlerë mbi 200 milionë euro çdo vit.
- (ii) TVSH 0% për prodhimin bujqësor e blegtoral MADE IN ALBANIA.
- (iii) Mbështetje direkte e prodhimit bujqësor për njësi të prodhimit, të sipërfaqes dhe për numër krerësh.
- (iv) Kredi të buta për infrastrukturë, serra, stalla, për industrinë agropërpunuese. Ofrim i tokës shtetërore për aktivitetet agropërpunuese.
- (v) Pajisja me Kartën e Fermerit me zbatimin e së cilës bëhet zbritja automatike e pagesës së TVSH-së për imputet bujqësore, (plehra kimike, fidanë, fara, naftë), për rimbursimet dhe mbështetje direkte.
- (vi) Konsolidim i rajonalizimit të prodhimit bujqësor. Fermerët do të orientohen dhe mbështetën finansiarisht për kultivimin e prodhimeve bujqësore mbi bazën e rajonizimit dhe avantazhet konkurrese.
- (vii) Nxitje e zinxhirit të vlerës në bujqësi duke stimuluar Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor.
- (viii) Krijimi i Tregut të Prodhimit Bujqësor, ku vendoset indeksi i çmimeve të ditës.
- (ix) Nxitje e zëvendësimit me përparësi të importeve të produkteve të përpunuara me prodhime vendi.
- (x) Zhvillimi me përparësi i blegtorisë, duke shtuar numrin e krerëve e shpendëve për konsum të brendshëm (Shqipëria prodhon vetëm 30% të kërkuesës për konsum) dhe për eksport. Hapja e eksportit për kafshët e gjalla dhe produktet shtazore, veçanërisht për të imtat.
- (xi) Heqja e TVSH-së për ushqimin e bagëtive dhe shpendëve të mishit, si soja, vaji i sojës, etj.
- (xii) Mbështetje financiare, me pagesa të drejtpërdrejta për çdo kafshë të lindur dhe çdo kafshë të therur respektivisht në masën 5€ dhe 7€ për të imtat (5€ fermeri dhe 2 thertorja); 20€ dhe 65€ për gjedhin (50 fermeri dhe 15 thertorja); 100€ për çdo lopë për qumësh; Mbështetje e drejtpërdrejtë për çdo litër qumësh (në masën 10 cent për litër).
- (xiii) Mbështetje me pagesë të drejtpërdrejtë për sektorin e bletarisë (rreth 400 mijë familje bletësh në masën 20€ për çdo familje).
- (xiv) Mbështetje e drejtpërdrejtë për çdo zog që importohet për prodhim mishi (në masën 1 € për krerë).
- (xv) Mbështetje për aquakulturën, me mbështetje të drejtpërdrejtë për rasatin dhe peshkun për konsum.
- (xvi) Zbatim me rigorozitet i masave kundër falsifikimit ushqimor të produkteve bujqësore e blegtorele.
- (xvii) Forcim i sigurisë ushqimore. Impute të sigurta dhe proces prodhimi i sigurt. Ndërtimi i një laboratori të kontrollit ushqimor për çdo qark.



**SHQIPËRIA  
SHTËPIA JUAJ**

*PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM*

## *IV. Turizmi, sektor kryesor ekonomie.*

- (i) Garanci shtetërore në ndërtimin e resorteve turistike.
- (ii) Mbështetje të investimeve në portet (marinat) turistike dhe prodhimin e mjeteve lundruese për industrinë e detit.
- (iii) Përjashtim nga taksat dhe tatimi mbi fitimin deri në 5 vjet për sipërmarrjet turistike në zonat rurale dhe në zonat e thella malore (shtëpi pritëse, struktura agroturizmi etj)
- (iv) Mbështetje direkte të taksës së ndërtimit në infrastrukturë për resortet turistike dhe rimbursimin e menjëhershëm të TVSH-së së kostos së ndërtimit të objektit në baza mujore.
- (v) Ndërtimi i aeroportit të Jugut. Stimuj finansiarë për të térhequr kompanitë ajrore me 'kosto të ulët'.
- (vi) Rritje e cilësisë dhe profesionalizmit të shërbimit turistik, sipas llojeve të turizmit dhe specifikave rajonale, kategorizim i strukturave turistike të të gjitha llojeve.



# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

PRÖPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM

## *V. Ndalim i shpopullimit dhe mbështetje e gruas dhe familjes*

- (i) Mbështetje për familjet e reja dhe rritje të lindshmërisë. Programi "nga bebjë në bebjë" (duke krijuar fondin për çdo fëmijë të lindur që do t'i kthehet në momentin që rritet dhe riprodhon vetveten: 1000 USD fond fillestar, deri në maturim rrëth 25 000 USD)
- (ii) Përcaktimi dhe miratimi i minimum jetik, si referim bazë për ndihmën ekonomike dhe asistencën sociale për çdo familje.
- (iii) Fuqizimin Ekonomik dhe Social të Gruas nëpërmjet programit "Arsim për Punësim", në mënyrë që gratë të emancipohen dhe fuqizohen ekonomikisht.
- (iv) "Strategjia për Gruan Sipërmarrëse", e cila do të jetë një paketë masash stimuluese financiare dhe fiskale për arsimimin, kualifikimin, trajnimin, zhvillimin dhe promovimin e nismës private për vajzat dhe gratë.
- (v) Fëmijëve të familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike do t'u ofrohet ushqim falas në çerdhet dhe kopshtet publike.



# **SHQIPËRIA SHTËPIA JUAJ**

**PROPOZIMET ZGJEDHORE 2021  
LËVIZJA SOCIALISTË PËR INTEGRIM**



[www.lsi.al](http://www.lsi.al) f